



Universiteti "Fan S. Noli" Korçë



Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

SIMPOZIUM

SFIDAT E KTHIMIT TË SHKOLLAVE NË QENDRA KOMUNITARE

Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë,
Universiteti i Korçës

Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit, Universiteti i
Durrësit

Korçë, Dhjetor 2016

PROGRAMI

10.30. Hapja e punimeve

Përhëndetja e Rektorit të Universitetit “Fan S. Noli”,

Prof. dr. Ali Jashari

Përhëndetja e Dekanit të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë,

Prof. as. dr.Pavlo Cicko

Mbajtja e kumtesave (7 min çdo kumtesë)

Ledja Kashahu (Xhelilaj).Qëndrimi i mësuesve ndaj përfshirjes prindërore në kuadrin e nismës ShQK

Irena Nikaj. Kultura e bashkëpunimit dhe ndryshimi në edukim në kuadër të komunitarizmit

Olger Brame. Një bashkëpunim i fuqishëm shkollë-komunitet, sa i rëndësishëm aq edhe i realizueshëm

Mirjam Reçi. Modele partneriteti për rritjen e bashkëpunimit shkollë-familje-komunitet

Adelina Nexhipi & Entela Kuruni . Shkolla qendër komunitare-përvoja nga gjimnazi “Themistokli Gërmenji” Korçë

Elda Tartari . Komunikimi midis mësuesit dhe prindit nëpërmjet teknologjive bashkëkohore

Arjan Kamburi & Ilirjana Nase. Shkolla - qendër komunitare dhe arsimit special në Shqipëri

12.00 - Pushim

12.15 - Tryezë e rrumbullakët: Shkolla dhe Universiteti qendra komunitare

Grupet e interesuara për këtë sfidë: Familja, shkolla, komuniteti, pushteti lokal, qeverisja

Shkolla qendër komunitare dhe arsimit gjithpërfshirës

Shkolla qendër komunitare dhe çështjet gjinore
Shkolla qendër komunitare dhe fëmijët me paaftësi
Shkolla qendër komunitare dhe mësuesit që punojnë së bashku
Universiteti si promotor i Reformës në Edukim dhe Shkollës
Qendër Komunitare
Universiteti dhe komuniteti i mësuesve
Universiteti dhe komuniteti, praktikave të mira. Të lidhim atë që
duhet me atë që bëjmë
Universiteti dhe shkolla qendër komunitare: përhapja e
praktikave të mira duke nxitur reflektimin dhe kërkimin

02 Dhjetor 2016

Salla e Konferencave “Jorgo Bulo” Nr. 321

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë

Hyrje

Sot universitetet gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë e ndryshimeve dhe reformave që synojnë sistemin arsimor, jo vetëm atë universitar por edhe atë parauniversitar. Kërkimi shkencor, përgatitja e profesionistevë të rinj, ngritja e qendrave të ekselencës për përgatitjen dhe formimin e vazhduar të profesionistëve në shërbim, kanë qenë dhe mbeten funksionet kyçe karakterizuese të insitucioneve të arsimit të lartë. Kërkimi shkencor përbën një nga fushat e ekselencës të universiteteve dhe shërben si urë lidhëse e këtyre insitucioneve me komunitetin dhe shoqërinë, me nevojat dhe problematikat e saj, të cilat bëhen shkak i përsiatjeve dhe diskutimeve në nivele akademike.

Nga konkluzionet e kërkimit shkencor në vendin tonë mbi rëndësinë e bashkëpunimit të shkollës, familjes dhe komunitetit, si dhe nga diskutimet në tryezën e përbashkët të grupeve të interesit mbi sfidat me të cilat përballet ky bashkëpunimi, mund të arrihet të ndërtohet një plan për veprim (strategji), se si mund të bëhet realitet kthimi i shkollës në një qendër të vërtetë komunitare.

Ne mendojme se edhe universiteti mund të kthehet në qendër komunitare, pasi edhe vetë simpoziumi , përmes kumtesave dhe diskutimeve nga të gjithë grupet e interesuara, do të shërbejë si mundësi që të bashkohen dhe koordinohen veprimtaritë dhe idetë. Në këtë mënyrë, universiteti do të mund të mbështesë zhvillimin profesional të mësuesve, me qëllim që të rritet cilësia e jetës në komunitet. Gjithashtu, universiteti si një institucion që ofron ekspertizë të nivelit të lartë në të gjitha fushat e jetës, përbën një burim të rëndësishëm dhe plot vlera për

komunitetin dhe zhvillimin e tij, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e mirëqenies bio-psiko-sociale në kuadër të të qenit social të çdo individi të shoqërisë tonë.

Sot, universitetet hapin dyert e tyre për komunitetin për të qenë pjesë, por edhe nismëtar i reformimit të shkollave si qendra komunitare.

PËRMBLEDHJA E ABSTRAKTEVE

Hyrje 4

Adelina Nexhipi

Entela Kuruni

SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE, PËRVOJA NGA
GJIMNAZI "THEMISTOKLI GERMENJI", KORÇË 7

Arjan Kamburi

Ilirjana Nase

SHKOLLA QËNDËR KOMUNITARE DHE ARSIMI SPECIAL
NE SHQIPËRI 9

Elda Tartari

KOMUNIKIMI MES MËSUESIT DHE PRINDIT NËPËRMJET
TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE 11

Irena Nikaj

KULTURA E BASHKËPUNIMIT DHE NDRYSHIMI NË
EDUKIM NË KUADËR TË KOMUNITARIZMIT 13

Ledia Kashahu (Xhelilaj)

QËNDRIMI I MËSUESVE NDAJ PËRFSHIRJES PRINDËRORE
NË KUADRIN E NISMËS SHQK 15

Mirjam Reçi

MODELE PARTNERITETI, PËR RRIJTJEN E BASHKËPUNIMIT
SHKOLLË, FAMILJE, KOMUNITET 17

Olger Brame

NJË BASHKËPUNIM I FUQISHËM SHKOLLË- KOMUNITETIT,
SA I RËNDËSISHME AQ EDHE I REALIZUESHËM 19

SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE, PËRVOJA NGA GJIMNAZI “THEMISTOKLI GËRMENJI”, KORÇË

Adelina Nexhipi

Drejtor - Gjinnazi “Themistokli Gërmenji”Korçë

Entela Kuruni

Zv drejtor -Gjinnazi “Themistokli Gërmenji”, Korçë

Abstrakt

Projekti qeveritar për shndërrimin e shkollës në qendër komunitare synon shndërrimin e shkollave në vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet me fokus zhvillimin akademik, social, fizik, dhe emocional të femijës duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron familja dhe komuniteti.

Gjinnazi “Themistokli Gërmenji” u zgjodh shkollë pilot për zbatimin e këtij projekti që në fillimet e tij, në vitin 2013.

Në këtë kumtesë do të prezantohen hapat e ndjekur në gjinnazin “Themistokli Gërmenji” për realizimin e këtij projekti, duke u ndalur te puna e berë nga shkolla, bashkëpunimi me prindërit, rezultatet e arritura, vështirësitë e hasura dhe bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm.

Në këtë studim rasti, të tipit përshkrues - analitik, do të merren në studim udhëzime, urdhra dhe vendime të Minisrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë, plane pune të gjinnazit “Themistokli

Gërmenji", evidenca dhe statistika të veprimtarisë së përditshme të shkollës.

Studimi synon të analizojë mundësitë ligjore dhe reale të bashkëpunimit mes shkollës, prindërve dhe komunitetit dhe vështirësitë që hasen në realizimin e këtij bashkëpunimi, duke u nisur nga përvoja konkrete 3 vjecare e zbatimit të projektit Shkollë qendër komunitare, në gjimnazin "Themistokli Gërmenji"

Fjalët kyçe: *shkollë qendër komunitare, gjimnazi "Themistokli Gërmenji", shkolla, prindërit, komuniteti.*

SHKOLLA QËNDËR KOMUNITARE DHE ARSIMI SPECIAL NE SHQIPËRI

Msc. Arjan Kamburi

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë
arjankamburi21@gmail.com

Ilirjana Nase

Psikologe, DAR Korçë
ilirjana.nase@gmail.com

Abstrakt

Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit përbën një nga fushat e standardeve të Shkollës Qendër Komunitare (SHQK), publikuar në vitin 2014 nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS, 2014). Një nga parimet udhëheqëse ku është mbështetur koncepti i Shkollës Qendër Komunitare është arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës. Mbi këtë parim kërkohet t’u sigurohet nxënësve plotësimi i të drejtës për arsim cilësor, mundësi të barabarta për t’u arsimuar dhe të drejtën për të qenë të ndryshëm. Modeli arsimor shqiptar ofron, në bazë të nevojave dhe vështirësive që prezanton fëmija, arsimim në shkollat e zakonshme dhe/apo në institucionet arsimore të specializuara, (MASH, L.69/2012). Duke iu referuar modelit arsimor shqiptar dhe strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020 (MAS, 2014), e ardhmja e shkollave speciale në Shqipëri mbetet një çështje akoma për t’u diskutuar. Në këtë studim do të prezantohen aspekte të reformave arsimore të aplikuar në

vende të ndryshme të botës, të cilat kanë reformuar edhe arsimin special brenda kornizës së arsimit gjithëpërfshirës.

Fjalët kyçe: *arsim gjithëpërfshirës, Shkolla Qendër Komunitare, shkolla speciale, shkolla qendër burimore, aftësi e kufizuar*

KOMUNIKIMI MES MËSUESIT DHE PRINDIT NËPËRMJET TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

Dr. Elda Tartari

Departamenti i Pedagogjisë, Fakulteti i Edukimit
Universiteti ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës
eldatartari@gmail.com

Abstrakt

Komunikimi mes mësuesve dhe prindërve luan një rol shumë të rëndësishëm dhe vendimtar në edukimin e fëmijëve. Studimet tregojnë se përfshirja e prindërve në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre përmirëson rezultatet në procesin e të mësuarit, ndikon në frekuentimin e shkollës në mënyrë të rregullt si dhe përmirëson sjelljen e fëmijëve dhe zhvillimin psikologjik të tyre. Gjithashtu, komunikimi i fortë është thelbësor për këtë partneritet edhe për ndërtimin e ndjenjes së komunitetit mes shkollës dhe familjes. Ky studim ka si qëllim që të shqyrtojë format e komunikimit nëpërmjet teknologjive bashkëkohore dhe të eksplorojë mundësitë e ndryshme të komunikimit për të përmirësuar komunikimin midis shkollës dhe familjes.

Mësuesit në ditët e sotme janë përdorues të teknologjive bashkëkohore, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm për të rritur dhe forcuar këtë lloj partneriteti. Nëpërmjet këtyre teknologjive, ata përdorin e-mailin, rrjetet sociale, bloget, websaitin e klasës si dhe aplikacionet telefonike për informacione , në lidhje me praninë e nxënësve, notat, ecurinë dhe problemet e tyre. Studimi

evidentoi që në vendin tonë këto forma komunikimi nuk përdoren gjerësisht. Sugjerimet praktike që ofrohen mund të duken shumë të thjeshta për ata që promovojnë në mënyrë aktive përfshirjen e prindërve në procesin e shkollës por, për fat të keq, shumë mësues nuk janë trajnuar dhe nuk i praktikojnë këto forma bashkëkohore komunikimin me prindërit. Ata duhet të vazhdojnë të zhvillojnë dhe të zgjerojnë aftësitë e tyre për llojet e komunikimeve nëpërmjet teknologjive në zhvillim në mënyrë që të maksimizojnë një komunikim sa më efektiv midis shkollës dhe familjes.

Fjalë kyçe: *Teknologji bashkëkohore, format e komunikimit ,shkollë, familje, ndjenjë komuniteti*

KULTURA E BASHKËPUNIMIT DHE NDRYSHIMI NË EDUKIM NË KUADËR TË KOMUNITARIZMIT

Dr. Irena Nikaj
Profesor i asociuar
Departamenti i Edukimit
Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë

Abstrakt

Çështjet në fokus të trajtimit tonë kanë të bëjnë me maksimizimin e arritjeve të reformës në edukim, me qëllim përmirësimin e rezultateve në shkolla, përmirësimeve cilësore të praktikave profesionale për mësuesit, duke mbajtur parasysh stabilizimin e shkollave përfshirëse dhe që plotësojnë nevojat e të gjithë atyre që i frekuentojnë, duke përfshirë edhe fëmijët me paaftësi.

Një kulturë shkollore mund të përcaktohet si besim dhe pritshmëri udhëheqëse dhe që qartazi shfaqet në mënyrën se si funksionon shkolla (Fullan, 2007).

Faktorët kyç në suksesin e kësaj reforme, sipas mendimit tonë, janë zhvillimi i kulturës së bashkëpunimit, që rrit cilësinë në shkollë, krijon kushtet për drejtim cilësor dhe demokratik, rrit pjesëmarrjen dhe interesin e nxënësve/studentëve për arritje sa më të kënaqshme për ata si dhe rrit cilësinë e përgatitjes së tyre, familjes, komunitetit dhe ndryshon e përmirëson sistemin shoqëror më gjerë.

Kultura e bashkëpunimit u lejon aktorëve të realizojnë synimet për të cilat funksionojnë institucionet e Edukimit, por, pse jo, shtron një rrugë që na afron me një shkollë që i

përmbush kriteret e të qenit një shkollë ndryshe, në një realitet që ndryshon me shpejtësinë që ndryshon teknologjia jetët tona.

Fjalët kyç: *familje, komunitet, kulturë, ndryshimi në edukim, shkollë*

QËNDRIMI I MËSUESVE NDAJ PËRFSHIRJES PRINDËRORE NË KUADRIN E NISMËS SHQK

Dr. Ledia Kashahu (Xhelilaj)

Departamenti i Pedagogjisë

Fakulteti i Edukimit

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës,

kashahuledia@yahoo.com

Abstrakt

Realizimi i nismës që synon kthimin e Shkollave në Qendra Komunitare është shumë i lidhur me perceptimet e mësueve mbi rolin e prindërve dhe qendrimet që ata mbajnë ndaj tyre. Pikërisht, për të zbuluar perceptimet e mësuesve, të cilët vlerësohen si faktor kyç në realizimin e kësaj nisme, u krye një studim i gërshetuar sasior dhe cilësor. Pjesa me natyrë sasimore e studimit u fokusua në matjen e disa aspekteve të bashkëpunimit shkollë-familje si: a) përfshirja prindërore; b) aftësia që kanë prindërit për të ndihmuar fëmijët; c) rëndësia e strategjive për përfshirjet specifike prindërore; d) konfidencialiteti prind-mësues; e) ftesat që u bëhen prindërve për bashkëpunim me shkollën. Për përpunimin e të dhënave sasimore u përdor paketa statistikore për shkencat sociale SPSS. Pjesa cilësore e studimit u përqendrua te zbulimi i faktorëve që vështirësojnë kthimin e shkollave në Qendra për Komunitetin. Për të këtë qëllim u realizuan intervista të pastrukturuara me 27 mësues, të cilat u përpunuan bazuar në teknikën e etiketimit dhe kodimit. Grumbullimi i të dhënave u realizua gjatë periudhës prill-qershor 2016. Gjetjet e këtij studimi treguan se një në tre mësues kanë

nivel të ulët besimi mbi përfshirjen prindërore edhe pse pjesa më e madhe e tyre kanë qendrime pozitive dhe e vlerësojnë si shumë të rëndësishme përfshirjen prindërore. Më shumë se gjysma e mësuesve mendojnë efikasiteti prindëror në ndihmë të fëmijëve është më i ulët se niveli mesatar. Pavarësisht nivelit të lartë të konfidencialitetit mësues-prind, përgjigja e prindërve ndaj ftesave të shkollës për pjesëmarrje në aktivitete shkollore u raportua e nivelit mesatar. Nga përpunimi i të dhënave cilësore rezulton se mësuesit shohin si pengesë të rëndësishme për kthimin e shkollave në qendra të vërteta komunitare mungesën e infrastrukturës shkollore, mungesën e fondeve për të paguar mësuesit për veprimtaritë ShQK, mungesën e fondeve për realizimin e veprimtarive të ndryshme si dhe mungesën e aftësive të prindërve për të qenë bashkëpunëtorë realë në planifikimin dhe vendimarrjet e shkollës.

Fjalët kyçe: *bashkëpunimi shkollë-familje, pjesëmarrja prindërore në planifikim, pjesëmarrja prindërore në vendimarrje*

MODELE PARTNERITETI, PËR RRIJEN E BASHKËPUNIMIT SHKOLLË, FAMILJE, KOMUNITET

Dr. Mirjam Reçi

Departamenti i Psikologjisë
Fakulteti i Edukimit,
Universiteti “A. Moisiu” Durrës

Abstrakt

Modelet e partneritetit mes shkollës dhe komunitetit janë të përhapura në botë përgjatë 30 viteve të fundit. Gjatë dekadës së fundit, një pjesë e shkollave 9 vjeçare po synojnë të forcojnë strukturat e prindërve për të realizuar më mirë komponentin e lidhjeve shkollë komunitet. Në një pjesë të rasteve, shkollat asistohen nga OJF-të, të cilat zbatojnë programe arsimore.

Në këtë kumtesë do të sjellim eksperiencën e zbatimit të një mini-projekti në shkollën 9 vjeçare “Shkolla e re”, ish-Kënetë Durrës, në bashkëveprim me organizatën FJA (Fëmijët janë e ardhmja). I gjithë qëllimi i nismës përmbli dhej në forcimin e bashkëpunimit të trekëndëshit shkollë- familje-komunitet. Nga zbatimi i aktiviteteve të projektit rezultoi se miniprojekte të tilla, rezultojnë në tejkalimin e sfidave, si: mosdiskriminimi i grupeve të marxhinalizuara (fëmijë nga komuniteti rom dhe egjiptian), numri i lartë i nxënësve në klasa, mungesë ambientesh për kryerjen e aktiviteteve, sigurimi i tereneve dhe kurrikulave për të qenë shkollë komunitare, përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në lojërat dhe aktivitetet e ndryshme të kurrikulave mësimore, integrimi i fëmijëve të ardhur nga emigrimi, etj.

Përfshirja e komunitetit në çdo hap zbatimi të projektit thekson transparencën dhe ndjenjën e dobishmërisë ndaj shkollës. Përtej sfidave të përfshirjes, doli qartë që kordinimi i mirë i pjesëmarrjes së nxënësve, mësuesve dhe prindërve në aktivitete sjell rezultate të larta jo vetëm në punën intelektuale të tyre (psh: tryezë e rrumbullakët nga ku del një plan veprimi), por edhe punën fizike dhe vullnetare (psh: rivitalizim i oborrit të shkollës dhe mbjellje e fidanëve dhe bimëve dekorative).

Veçanërisht në komunitete me shumë problematika, si : ish-Këneta Durrës, nisma të tilla janë modele pozitive për t'u ndjekur edhe nga shkolla në qendra urbane dhe me më shumë vite eksperiencë në përfshirjen komunitare.

NJË BASHKËPUNIM I FUQISHËM SHKOLLË-KOMUNITETIT, SA I RËNDËSISHME AQ EDHE I REALIZUESHËM

Msc. Olger Brame

Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Abstrakt

“Shkolla si qendër komunitare” është një nismë që synon ta kthejë shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpu-nohet për zhvillimin e mundësive të plota të çdo nxënësi. Qëllimi është që shkolla të bëhet një mjedis që i shërben komunitetit, por edhe komuniteti si një partner i rëndësishëm që e mbështet shkollën.

Nga ana tjetër është ende e përhapur prirja që shkollat dhe komunitetet të shohin njëri-tjetrin me mosbesim. Secila ka zhvilluar një sy të mprehtë për dobësitë e tjetrit.

Me argumentet në punimin tonë, do të përpiqemi të kuptojmë se përfitimet nga lidhjet shkollë -komunitet janë të rëndësishme dhe të dyanshme. Shkollat bëhen anëtare të komunitetit, duke ruajtur marrëdhënie të qëndrueshme në nivele të larta. Perceptimet e nxënësve përmirësohen. Ata shihen tani si “fëmijë që jetojnë në komunitetin tonë dhe jo të huaj”. Gjithashtu, fqinjët njohin asetet e nxënësve dhe vlerën e pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet e komunitetit. Shkollat do të përfaqësojnë një vend qendror për të ndarë informacion me banorët e komunitetit, si dhe nxënësit

mund të shërbejnë si vullnetarë dhe praktikantë në organizime dhe ndërmarrje me bazë komunitetin.

Fjalët çelës: *shkollë, komunitet, bashkëpunim, rëndësi, përfitim*